



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Datë/a:	19.05.2021
Referenc-ë:	07-353/04-82654/21
Për/ Za/ To:	Advocacy Training and Resource Center - Lirika Bakija
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike
	Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr. protokollit 07-353/04-82654/21 nga Advocacy Training and Resource Center dhe Save the Children në bashkëpunim me zyrën për Qeverisje të mirë me përfaqësuese Lirika Bakija Projekt Menaxhere me të cilën kërkohet që me datë 1 Qershor 2021 nga të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike, sheshi "Zahir Pajaziti" tek pjesa e Amfiteatrit afër Hotel Grandit. Qëllimi i aktivitetit është ti argëtojmë fëmijët përmes ngjyrosjes së fytyrës, muzikës si dhe duke ju dhuruar nga një libër me përralla për ngjyrosje përmes të cilit fëmijët mund të mësojnë të drejtat e tyre.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për "Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronë Publike" me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin "Zahir Pajaziti" me datë 1 Qershor 2021 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.